



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. ____Prot.,

Tiranë, më __/__/2024

V E N D I M

**PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Artur Selimaj
Nr. 55, datë 11.11.2024**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbrojtjes Policore, e përbërë nga:

**Klevis Dhigoi
Ersa Karaj
Erjana Pjetri**

**Relator
Kryesuese
Anëtare**

në datën 01.11.2024, në orën 11:30, në ambientet e Agjencisë së Mbrojtjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Artur Lavdi Selimaj, me funksion aktual Shef Sektori, në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatorit së çështjes, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, shtetasi z. Artur Lavdi Selimaj, ishte subjekt i vlerësimit kalimtar nga trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit datë 04.07.2023, me pozicionin “Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier.”
3. Subjekti i vlerësimit **z. Artur Lavdi Selimaj**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga trupat e vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr.1 datë 24.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Klevis Dhigoi (Relator), znj. Ersa Karaj (Kryesuese) dhe znj. Erjana Pjetri (Anëtare).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr.2 datë 24.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **z. Artur Lavdi Selimaj**.
6. Relatori i çështjes, z. Klevis Dhigoi nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 26.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të

vlerësimin të deklarohet nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimin.

7. Subjekti i vlerësimin ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me datë 26.07.2023 duke shprehur nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimin.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimin kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12.2018 i ndryshuar relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimin si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** Prot, datë 25.07.2023, ka dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr. *** Prot, datë 25.07.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimin të aftësive profesionale
 - c. me shkresën nr. *** Prot, datë 25.07.2023 ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimin kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimin është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimin kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimin ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - d. Ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - e. Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;

- g. Rregulloren nr. 197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”;
 - h. duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore që janë:
 - ✚ *Deklarata e Pasurisë,*
 - ✚ *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
 - ✚ *Formulari i Vlerësimit Profesional*
 - ✚ *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,*
 - i. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 - j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
 - k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;
 - l. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
13. Trupa e vlerësimit, në datën 03.09.2024 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Artur Selimaj, me Vendimin nr. 3 datë 03.09.2024, vendosi:
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Artur Selimaj,
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, të ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar
15. Në datë 04.09.2024, trupa e vlerësimit i ka njoftuar subjektin të vlerësimit me e-mail, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe i ka dërguar relacionin paraprak për njohje.
16. Në datën 10.09.2024, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është dërguar nga e-maili i subjektit të vlerësimit, një e-mail nga shefi i sektorit të rendit publik i cili na informon se subjekti i vlerësimit është me leje vjetore nga data 26.08.2024 deri më datë 15.09.2024.

17. Në datën 26.09.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 30.09.2024, në orën 11:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
18. Pasi është dërguar njoftimi për seance dëgjimore, në datën 26.09.2024, trupa e vlerësimit është njohur me shkresën nr.xxx Prot, datë 25.09.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku na informon se me “Urdhër nr. ***, datë 13.09.2024, “*Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie*”, me anë të të cilit z. Artur Selimaj, është transferuar dhe emëruar në detyrën Shef Sektori, në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike , pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.
19. Në datën 30.09.2024, është çelur seanca dëgjimore, ku u konstatua se subjekti i vlerësimit nuk ishte prezent, në këto kushte trupa e vlerësimit vendosi të riplanifikojë dhe të njoftojë subjektin e vlerësimit për zhvillimin e procesit.
20. Në datën 30.09.2024, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është dërguar nga subjekti i vlerësimit, nëpërmjet postës elektronike personale, raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë nga data 30.09.2024 deri më datë 14.10.2024.
21. Në datën 03.10.2024, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është dërguar nga subjekti i vlerësimit, nëpërmjet postës elektronike personale, urdhrin e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm “*Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie*”, që subjekti i vlerësimit z. Artur Selimaj, ushtronte pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, duke u emëruar për nevoja pune në një pozicion që nuk parashikohet në nenin 6, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, në kushtet kur nuk kishte marrë vendim përfundimtar për përfundimin e hetimit administrativ.
22. Në datën 16.10.2024, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është dërguar nga subjekti i vlerësimit, nëpërmjet postës elektronike personale, raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë nga data 14.10.2024 deri me datë 28.10.2024.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

23. Trupa e Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, administroi dokumentacionin si vijon:
- Urdhër nr. ***, datë 13.09.2024, “*Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie*”, me anë të të cilit z. Artur Selimaj, është transferuar dhe emëruar në detyrën Shef Sektori, në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike , pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - E-mailin personal e datës 03.10.2024, të subjektit të vlerësimit z. Artur Selimaj, në të cilin njoftohet Agjencia e Mbikëqyrjes Policore se subjekti i vlerësimit ka ndryshuar pozicion pune.

24. Për këtë arsye z. Artur Lavdi Selimaj,

- *Nuk është subjekt i vlerësimit kalimtar, për shkak të pozicionit të tij të punës jashtë fushës së ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar (Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore), pozicion që nuk përcaktohet në pikën 1, të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

25. Në këto kushte, Trupa e Vlerësimit, në zbatim të nenit 95të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, deklaroi të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura, janë bërë ligjërish të pamundur.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në nenin 95, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit z. Artur Lavdi Selimaj, me funksion aktual Shef Sektori, në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rentit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet z. Artur Selimaj, si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim u shpall sot më datë 11.11.2024, në Tiranë.

Ersa KARAJ

Kryesues

Klevis DHIGOI

Relator

Erjana PJETRI

Anëtare